



**Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale / Direktorat za Zdravstvo i Socijalnu
Zaštitu / Department of Health and Social Welfare**

Nr: 4-453/01-39095/20
Datë 02/06/2020.
Gj i l a n

Në bazë të Rregullores së Ministrisë së Financave Nr: 04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nxjerr këtë :

V E N D I M

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekte/programet, të organizatave jo-qeveritare në fushën e mirëqenies sociale.

-I-

1. Për implementimin e thirrjes publike, do të zbatohen dispozitat e rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projekt/programet e OJQ-ve, nga Buxheti i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale kodi ekonomik: **10,21 dhe 31** në kuadër të programit/nënprogramit/ të subvencioneve

-II-

1. Mjetet do të shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve. Sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes e cila është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

-III-

1. Dokumentacioni i zbatimit të thirrjes publike sipas pikës II, të këtij Vendimi përfshinë:

1. Tekstin e thirrjes publike
2. Udhëzimin për aplikantët
3. Formularët e aplikimit
4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
5. Format për raportimin e zbatimit të projektit

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1, të këtij neni janë:

1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit

Komuna e Gjilanit | Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Gjilan 60000 | Republika e Kosovës
<https://kk.rks-gov.net/gjilan/>

2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
3. Forma e deklaramentit të mungesës së fondeve të dyfishta
4. Deklarata e partneritetit (nëse është e aplikueshme)
5. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ^{ve}, të financuara nga burimet publike
6. Deklarata për aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet)

3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

-IV-

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare (veb faqe)

-V-

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ^{te} dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijoj një komision vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlersimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranura që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurimit sipas paragrafit 1, të këtij neni.
3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ^{ve}.

-VI-

1. Pasi të merret Vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr Vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ^{ve}.
2. Ofruesi i mbështetjes financiare do të njëftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave. Përgjegjës për zbatimin e këtij Vendimi është Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

-VII-

Ky Vendim hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit dhe protokolimit

